**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**
Opština Priština – Municipality of Prishtina

PRISHTINA

# Njoftim Publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni/kërkesa 05 Nr. 350/02-176201/21 dt. 25.08.2021, në emër të aplikuesit Hilmi Makovci nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste, me karakter të përkohshëm, me etazhitet P+0, dhe me destinim-përmbajtje: pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant, market dhe barnatore, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 2916-6 ZK Prishtinë, e cila ndodhet në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria” dhe PZHU-së në Prishtinë.

Me aplikacion-kërkesë, është prezantuar edhe projekti konceptual - projekt propozimi për kushte ndërtimore. Ky njoftim vendoset në parcelën kadastrale nr. 2916-6 ZK Prishtinë, duke u bazuar në pikën 2 të nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, për ti mundësuar publikut dhënien e komenteve për kërkesën për caktim të kushteve ndërtimore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 08.09.2021 deri më 22.09.2021, në e-mail adresën: **urbanizmiprishtine@rks-gov.net**

| Kushtet e propozuara të ndërtimit | |
|---|---|
| a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: | Ndërtesë afariste e përkohshme, me destinim-përmbajtje: pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant, market dhe barnatore, me etazhitet P+0 |
| b. Vija rregulluese | Në kufi të parcelës nr. 2916-6 |
| c. Vija ndërtimore | 10.00 m` |
| d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike | 6.04 m`/9.67 m`, streha<br>4.95 m'/~35.00 m`, ndërtesa |
| e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale. | 6.04 m`/~7.50÷18.20 m`, streha<br>6.04 m`/~24.67 m`, streha<br>4.95 m`/~1.92÷5.93 m`, ndërtesa<br>4.95 m`/~6.67÷7.63 m`, ndërtesa |
| f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | ISHP=40 % =960.00 $m^2$, e lejuar,<br>S=395.10+578.30=973.40 $m^2$, e propozuar |
| g. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | ISHGJ~ 40% =960.00 $m^2$ e lejuar, 414.40 $m^2$ e propozuar |
| h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | ISPN=40 % =960.00 $m^2$ e lejuar, 973.40 $m^2$ e propozuar |
| i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | / |
| j. Numri i hapësirave për vend parkime në kuadër të parcelës<br>k. Vend parkime të automjeteve | 13 vendparkime |
| l. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese | / |
| m. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja | / |
| n. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike?<br>Po x Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ | |
| o. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth?<br>Po ☐ Jo x Nuk aplikohet ☐ Sqaro: | |
| p. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura?<br>Po ☐ Jo x Nuk aplikohet ☐ Sqaro: | |

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: